



KOMITETI OLIMPIK
KOMBETAR SHQIPTAR

INFORMACIONE

Janar - Shkurt 2010

Shqipëria pjesëmarrëse në Lojërat e XXI Olimpikë Dimërore "Vancouver 2010"



vancouver 2010



Datat: 12-28 Shkurt



Skiatori **Erjon TOLA**, për herë të dytë në Olimpiadën Dimërore

3 Shkurt 2010

Ceremonia e dorëzimit të flamurit kombëtar skiatorit Erjon Tola nga Presidenti i Republikës

Ceremonia zyrtare e dorëzimit të flamurit kombëtar Delegacionit pjesëmarrës në Lojërat Olimpikë Dimërore "Vancouver 2010", u zhvillua në datë 03 Shkurt 2010 në Presidencë.

Presidenti i Republikës, Prof. Dr. Bamir Topi përshëndeti Delegacionin Shqiptar dhe i dorëzoi flamurin kombëtar skiatorit Erjon Tola. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm Presidenti i KOKSH, z. Agim Fagu, Zv.Ministri I MTKRS z. Dashnor Bajaziti, Anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH dhe Përfaqësues të Federatës Shqiptare të Skive. Pas ekzekutimit të Himnit Kombëtar dhe atij Olimpik, Kreu i shtetit i dorëzoi skiatorit Erjon Tola flamurin kombëtar kuq e zi, i cili do të valëvitet mes qindra vendeve pjesëmarrëse në Lojërat Olimpikë Dimërore 2010, në Vancouver të Kanadasë nga 12-28 Shkurt 2010. Fjalën e parë përshëndetëse e mori z. Fagu, i cili përgëzoi skiatorin Tola për realizimin e ëndrrës Olimpikë dhe theksoi rëndësinë historike të pjesëmarrjes së Shqipërisë por gjithashtu edhe si një model për inkurajimin e të rinjve të tjerë të merren me këtë sport. Në vijim, në fjalën përshëndetëse z. Bajaziti në emër të MTKRS uroi skiatorin Tola dhe theksoi rolin e Ministrisë për një vëmendje më të madhe ndaj sporteve dimërore dhe mbështetje të të gjitha sporteve në përgjithësi.



Presidenti i Republikës z. Bamir Topi, iu drejtua të pranishmëve në këtë ceremoni dhe të gjithë pjesëmarrësve në Lojërat Olimpikë Dimërore duke u shprehur:

"I nderuar zoti Zëvendësministër Bajaziti,

I nderuar zoti Fagu,

Të nderuar përfaqësues jo vetëm të botës së sportit e të Olimpizmit!

Të nderuar përfaqësues të medias dhe do ta specifikoja të medias sportive, sepse fatmirësisht sot kemi një kualifikim dhe të dimensionit të medias!

Edhe për mua është një moment i veçantë, një nga ato emocione që të jep bota e sportit, por natyrisht të jep edhe simbolika e këtij aktiviteti, simbolika që lidhet me dorëzimin e flamurit kombëtar. Besoj se ky është një moment emocionues për të gjithë dhe mbi të gjithë wshtw moment emocionues për Erjonin, i cili ndonëse përfaqësues i vetëm në këto gara, do të jetë ai që do të ketë në dorë flamurin kombëtar me një mesazh shumë të fortë. Ne do të dëshironim që pjesëmarrja të ishte më e gjerë, por tek e fundit është shumë e rëndësishme të marrësh pjesë. Në një farë mënyre jeni pikë referimi për këtë lloj sporti, i cili paradoksisht në një vend me një terren kryesisht malor nuk praktikohet edhe aq, jemi mësuar ta studiojmë që në vitet e para kur kemi mësuar gjeografinë fizike të vendit tonë, rreth tre të katërtat e territorit është kodrinor-malor dhe faktikisht sot kemi një sport, i cili përveç disa elementeve të zbehur të traditës, edhe atë sportist që kemi e ushtron këtë lloj aktiviteti jashtë këtij terreni.

Mesazhi im përtej simbolikës shumë të rëndësishme është mesazh që e bëj me vëmendjen për t'iu kthyer traditës, për ta shfrytëzuar këtë mundësi të jashtëzakonshme që na ka dhënë Zoti dhe natyra dhe për ta ushtruar këtë sport, sepse është një sport, i cili frekuentohet sot nga miliona njerëz. Mjafton të shkosh në ato vende që e kanë traditë për të parë sesa masiv është ky sport. Unë ju falenderoj sinqerisht në emrin tim dhe në emër të të gjithë shqiptarëve që jeni pjesë e këtij kompeticioni të rëndësishëm në Lojrat e 21-ta Olimpike ku flamuri shqiptar do të ngrihet në Vancouver. Është shumë e rëndësishme që do të jeni pikë referimi për të edukuar brezat.

Përtej kësaj simbolike do të jap dhe mesazhet e mia për të gjitha institucionet, të cilat duhet të shohin Olimpizmin si një element shumë të rëndësishëm për edukimin e brezit të ri. Ky është roli më i rëndësishëm me të gjithë elementet pedagogjikë dhe psikologjik të formimit të brezit të ri i jepet një rëndësi e jashtëzakonshme edukatës fizike dhe besoj që ky është mesazh që jepet sot drejtpërdrejtë edhe nëpërmjet këtij aktiviteti. Kur thashë që ne e kemi të domosdoshme që ta zhvillojmë këtë sport mjafton të shohësh Tiranën me gati një milion banorë, të shohësh edhe një mal, i cili i qëndron gjithmonë si kurorë qytetit të Tiranës dhe të shohësh që nuk ka asnjë skiator në ato qafa, nuk ka as një pistë, pra duhet të japim patjetër edhe sensin e realitetit, të realizmit të gjërave. Përtej Dajtit ka dhe vende të tjera të mrekullueshme. Pra dëshiroj t'u bëj apel, t'u bëj thirrje jo vetëm institucioneve, dëshiroj t'u bëj thirrje edhe kompanive private, t'i bëj thirrje edhe pushtetit vendor, i cili administron territorin, t'i bëj thirrje politikës, e cila duhet të jetë e vëmendshme jo vetëm thjesht për debatin politik të ditës. Jeta nuk është vetëm debat politik. Debatit politik është në funksion të shumë elementëve të tjerë. Jeta fatmirësisht ka shumë dimensione: politik, institucional, administrativ, ekonomik, por ka dhe dimensionin sportiv. Dikush e sheh vetëm si argëtim, unë do të thoja që nuk është thjesht argëtim, por është edukim. Kjo është arsyeja që sot ndjehem i nderuar që pjesëmarrja në këtë aktivitet për një përfaqësim, është kaq e gjerë me njerëz shumë të nderuar, me njerëz që i kam parë të angazhohen gjatë gjithë jetës për këtë element që është një element shumë substancial tek njeriu - të dijë të jetë i edukuar dhe të edukojë të tjerët. Kjo është arsyeja që unë ndjehem vërtetë i nderuar, ndiehem i emocionuar në këtë ceremoni dhe për një arsye tjetër: që i vjen radha sërish dorëzimit të flamurit kombëtar Erionit duke i uruar atij dhe sportit shqiptar suksese në këtë kompeticion, por edhe në shumë kompeticione të tjera! Urime!"



Pershendetje nga Fshati Olimpik "Vancouver 2010" / Shefi Misionit ,Shkëlqim Mema

2010-02-12

Në Fshatin Olimpik u organizua "Welcome Ceremony" e Shqipërise dhe me këtë rast zyrtarisht u ngrit Flamuri Kombëtar Shqiptar ndër 91 shtete pjesëmarrëse. Në ceremoni ishte i pranishëm edhe Ambasadori Shqiptar ne Kanada z. Besnik Konci.

Megjithëse deri dje Vancouver kishte pranvere sot ka filluar debora ne mal per ti dhene vleren e duhur Lojerave Olimpikë. Ekipi Shqiptar ka ndjekur me kujdes udhezimet e organizatoreve dhe eshte pershtatur mire me klimen dhe ambjentin qe na rrethon. Erjoni ka bere rregullisht stervitje në pistë dhe gjithashtu ka zhvilluar seanca stervitore ne palester sic bejne thujase te gjithë skiatoret e tjere. Ndryshe nga perpjekjet tona qe Erjoni te garonte ne te tre garat (slalom, slalom gjigan dhe super gjigand) perfundimisht Federata Nderkombetare e Skive konfirmoi zyrtarisht qe nuk do te beje supergjigand(sg) por do te jete ne slalom special ne date 27.

Gjithashtu ne Vancouver do te kete nje pritje nga Komuniteti Shqiptar ku do te marrin pjese Ambasadori, Presidenti dhe Sekretari i KOKSH, Shefi i Misionit, Erjoni, dhe te ftuar te tjere.

Sot do te jete edhe ceremonia me emocionuese ajo e Hapjes se Lojerave e cila do te jete nje ceremoni spektakel ku do te transmetohen vlerat e miqesise, paqes, respektit, lojes se ndershme, vlerave njerezore dhe te natyres. Ekipi Shqiptar megjithese modest dhe i vogel do te parakaloje krenar nder 91 kombe te tjere duke valëvitur flamurin kuq e zi.

KOMUNITETI SHQIPTAR NE KANADA I PERFSHIRE NE ENTUZIZMIN DHE EMOCIONET E LOJERAVE OLIMPIKE

Komuniteti Shqiptar ne Kanada e ka perjetuar ne nje menyre te vecante eksperiencen e Lojerave Olimpikë Dimerore. Ndonese me nje sportist, pjesemarrja e Shqiperise i ka dhene mundesine Komunitetit Shqiptar ne Kanada ta ndejne ne menyre te vecante dhe me afer atmosferen Olimpikë te ketyre lojerave. Ata me menyren e tyre kane qene protagonist te organizimeve apo mbeshtetjes se delegacionit tone te vogel per te mos u ndjere vetem. Nje mbeshtetje te vecante e ka ndjere edhe sportisti yne Erjon Tola.

*Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar
gjen rastin të Falenderojë gjithë
Komunitetin Shqiptar në Kanada për
inkurajimin dhe interesin tuaj!*



REZULTATI - Renditja perfundimtare Raundi 1 i 69-ti me kohe totale 1:27.57 dhe Raundi 2 i 63 me kohe 1:31.70

Raundi 1		Raundi 2	
	Koha (Diff)		Koha (Diff)
Int 1	17.82 (+1.85)	Int 1	20.46 (+2.15)
Int 2	47.13 (+6.08)	Int 2	50.39 (+6.34)
Int 3	1:03.26 (+7.62)	Int 3	1:07.27 (+8.62)
Mbarim	1:27.57 (+10.30)	Mbarim	1:31.70 (+11.55)



26 Janar 2010

Deklaratë për shtyp e KOKSH : Kundër dhunës në sport

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar shpreh qëndrimin e tij në lidhje me demonstrimin e akteve të dhunshme të ndodhura gjatë zhvillimit të ndeshjes së futbollit Tirana – Dinamo në stadiumin Qemal Stafa, të cilat lënë një shije të hidhur për imazhin e sportit dhe vlerat e tij. KOKSH i bindur në filozofinë dhe misionin e Lëvizjes Olimpikë dhe Sportive që promovon paqen, respektin, lojën e ndershme të bazuar në rregulla, e ndjen për obligim të dalë me këtë deklaratë për të dënuar dhunën në sport. Ne, besojmë plotësisht në parimet themelore të Olimpizmit dhe dënojmë me forcë çdo akt dhune apo diskriminimi në çfarëdo lloji forme të shfaqjes së saj, se akte të tilla, nuk janë aspak etike madje në kundërshtim me frymën e Fair Play . KOKSH dënon çdo akt dhune, diskriminimi apo fyerje e shfaqur kjo në të gjitha ambientet sportive.

Ne dënojmë me forcë çdo shfaqje dhune apo veprim që është në kundërshtim me frymën e Olimpizmit dhe Fair Play, vlerat e tolerancës dhe të miqësisë në sport KOKSH është i bindur se akte të tilla do të dënohen gjithmonë nga autoritetet përkatëse për të mbrojtur vlerat dhe lavdinë e sportit dhe që këto të mos jetë një fenomen i zakonshëm i kulturës sportive në shoqërinë tonë. Ne kërkojmë nga të gjithë aktorët sportivë dhe publikë, ata që ndikojnë në mënyrë direkte apo indirekte në sport, dhe në vecanti sportistëve, trajnerëve, zyrtarëve, tifozëve, etj. që të japin kontributin e tyre për shfaqjen e vlerave të vërteta të sportit. Në kushtet kur Shqipëria po aspiron të renditet dhe ajo përkrah shteteve të tjera europiane si e barabartë me ta në BE është e nevojshme dhe ne të jemi në të njëjtën linjë të bashkëpunimit evropian në luftën kundër dhunës në sport duke nxitur aktivisht zhvillimin e parandalimit të dhunës dhe përmirësuar zhvillimin e sportit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Parimet themelore të Olimpizmit (Karta Olimpikë)

- 1. Olimpizmi është një filozofi e jetës, duke lartësuar dhe kombinuar në një tërësi të ekuilibruar cilësitë e trupit, vullnetit dhe mendjes. Duke ndërthurur sportin me kulturë dhe arsim, Olimpizmi kërkon të krijojë një stil jete të bazuar në kënaqësi e përpjekje, vlera edukative të shembullit të mirë dhe respektit për parimet themelore etike universale.*
- 2. Qëllimi i Olimpizmit është të vendosi sportin në shërbim të zhvillimit harmonik të njeriut, me synimin për të promovuar një shoqëri paqësore dhe ruajtjen e dinjitetit njerëzor.*

30 Janar 2010

Seminar “Performanca e lartë e stafeve dhe organizimi i ekipeve të punës në organizatat sportive”



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar organizoi në ambientet e AEFS “Vojo Kushi”, në datë 30 janar 2010, Seminarin e hapur me temë: “Performanca e lartë e stafeve dhe organizimi i grupeve të punës në Organizatat Sportive”. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin sekretarë të federatave sportive kombëtare dhe të ftuar nga Komuna e Tuzit, Mali i Zi. Seminari u hap me përshëndetjen e Sekretarit të Përgjithshëm të KOKSH z. Stavri Bello dhe Rektori i AEFS z. Vejsel Rizvanolli. Drejtuesit e seminarit ishin:

Dr. Thierry Zintz - Lektor për Menaxhimin e Organizatave Sportive në Universitetin të Louvain, Belgjikë i cili mbajti temën “Performanca e lartë e stafeve dhe organizimi i ekipeve të punës në Organizatat Sportive” dhe **Master Alma Papić** - Master Ekzekutiv për Menaxhimin e Organizatave Sportive Olimpikë - nga Kroacia e cila prezantoi temën “Sistemi Sportiv në Kroaci”

Seminari ofroi një panoramë rreth aspekteve të krijimit të një menaxhimi performues dhe administrimit të ekipeve të punës brenda Organizatave Sportive (Federata dhe Klube), në mënyrë që të prodhohet një nivel i lartë shërbimesh tek të gjithë personat që kanë të bëjnë me sportin dhe në vecanti me sportistët elitare. Me shumë interes ishin dhe diskutimet nga të pranishmit të cilët prezantuan një sërë pyetjesh për lektorët.

Në zyrat e KOKSH gjithashtu u organizua një takim i vecantë midis Drejtorëve Kombëtar të Administratorëve Sportivë dhe lektorëve të ardhur të cilët kanë diskutuar lidhur me projektin që do të nisë së shpejti: “Kursi i Avancuar mbi Menaxhimin e Organizatave Sportive Olimpikë”, i cili është nën patronazhin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

11 Janar 2010 Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv

U zhvillua nw datw 11 Janar 2010 nw zyrat e KOKSH mbledhja e parw e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH për vitin 2010. Ndër të tjera në rend të ditës u diskutua : Formimi i komisioneve të KOKSH; miratimi i kalendarit të aktiviteteve të KOKSH për vitin 2010 etj.

12 Janar 2010 Takim Orientimi (Bratislavë)

Komiteti Olimpik Sllovak priti në 12 janar 2010 në Bratislavë, një Takim Orientimi me përfaqësues të CEO dhe Komiteteve Olimpikë të Europës Qwndrore dhe Jugore.

Në këtë takim pati pjesëmaarës nga 11 vende, ku Shqipëria u përfaqësua me anëtarin e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, z. Gëzim Panariti. Ndër temat e trajtuara ishin : Sporti në BE, evolimi, problemet , perspektivat; Impakti i aktiviteteve të Bashkimit European mbi sektorin e sportit Sllovak etj.

15 Janar 2010 Mbledhje e Komisionit Teknik të KOKSH

Me kërkesë të kryetarit të Komisionit Teknik të KOKSH, z. Viron Bezhani, u mbledh në zyrat e KOKSH në datë 15 janar 2010, Komisioni i ri Teknik. Në mbledhje mori pjesë edhe Presidenti i KOKSH, z. Agim Fagu, i cili bëri prezantimin e anëtarëve të rinj të komisionit të cilët janë: z. Koco Mikerezi, z. Bujar Shehu, zj. Klesta Meta, z. Endri Haxhihyseni, z. Labo Capo, z. Ylli Tomorri, z. Astrit Hafizi. Ndër pikat më të rëndësishme të rendit të ditës të cilat u diskutuan ishin: hartimi i një programi pune të komisionit për periudhën para-olimpikë 2010 -2012, si dhe kriteret dhe programi i bursave olimpikë për sportistët e rinj.

27 Janar 2010 Mbledhje e komisionit “Femra & Sporti”

Komisioni i ri “Femra & Sporti” i KOKSH u mbledh për herë të parë në zyrat e KOKSH në datë 27 Janar 2010. Kryetarja e këtij komisioni, znj. Hyrmete Gjetaj përshëndeti anëtarët e reja të cilat janë: zj. Liljana Karanxha, zj. Lindita Spaho, zj. Nexhmije Kotrri, zj. Polikseni Gorishti, zj. Vjollca Haziollari, zj. Natasha Kotorri. Pjesëmarrëset në mbledhje diskutuan për një sërë temash si: rëndësia dhe detyrat e këtij komisioni në promovimin e rolit të femrës, si dhe u hodhën ide për aktivitete të ndryshme që do të përfshihen në programin e punës së këtij komisioni për vitin 2010.

5 Shkurt 2010 Mbledhje e Komisionit Teknik të KOKSH



Ditën e Premte, datë 5 Shkurt 2009, u zhvillua në zyrat e KOKSH një takim me pjesëmarrjen e :

Komisionit Teknik të KOKSH dhe Sekretarët e Përgjithshëm të Federatave Sportive Takimin e celi Presidenti i KOKSH z. Agim Fagu i cili theksoi rëndësinë e këtij takimi dhe domosdoshmërinë e fillimit të menjëhershëm të punës me përgatitjet për Lojërat Olimpikë “Londër 2012” . Pjesëmarrja e sportistëve tanë dhe suksesi i tyre në Kampjonatet Botërore dhe Evropiane për kualifikimin e nevojshëm do të jetë synimi më konkret në angazhimet

tona. Angazhimi i federatave për zbatimin e kriterëve do të mund të sigurojë një selektim të kujdesshëm dhe nga ana e Komisionit për të bërë të mundur që sportistët tanë elitare të mund të marrin përfitimin e duhur nga Bursat Olimpikë.

Në diskutime morrën pjesë të gjithë pjesëmarrësit të cilët konkluduan si një domosdoshmëri impenjimin për respektimin e kriterëve dhe opinionet e përbashkëta për zgjidhjet sa më të mira të mundshme në shfrytëzimin e bursave olimpikë .

Part of speech hold from Mr. Bamir Topi –President of Republic of Albania , during Delivery Ceremony of national Flag.

.....Beyond this symbolic I want to deliver my message to those institutions, which should consider Olympism as a very important element for the education of the young generation. This most important role with all the elements of pedagogical and psychological training of young generation emphasizes the extraordinary importance of physical education and I believe that this message is conveyed directly today through this activity.

So I want to appeal to the local government, which administers the territory, to the political forces, which should be attentive not merely to the political debate of the day. Life is not just political debate. The political debate is in function to many other elements.

Life, fortunately, has many dimensions: political, institutional, administrative, economic, as well as the sporting dimension, which is seen only as entertainment, but I would say that is not just entertainment, but education. That is why today I feel honored that the participation in this ceremony is so broad with so many distinguished people, with people that I have seen engage their whole life in this element, that is a very substantial element to man – knowing how to be educated and educate others. This is why I feel really honored and overwhelmed in the ceremony, and for another reason as well: that Erjon has the chance to receive the national flag again, and I wish him and Albanian sports in this competition success, but also in many other Competitions! Congratulations! “

30 January 2010

Seminar “High performance teams and team building in Olympic Sport Organizations”

The National Olympic Committee of Albania in pursuit of its strategy and efforts to a better qualification and improvement of human resources working in sports organizations, organized at the “Vojo Kushi” Academy of Sports and Physical Education (AEFS), a seminar on the topic of:

High performance teams and team building in Olympic Sport Organizations

As seminar lecturers, NOC Albania invited:

Dr. Thierry Zintz – Lecturer for the Sports Organizations Management at the Louvain University in Belgium, who presented the topic: HRM - High performance teams and team building in Olympic Sport Organizations

and **Master Alma Papić** - MEMOS – from Croatia, who introduced the topic : “*The sports system in Croatia*”.

The seminar as a whole was interesting and very valuable. The topics offered an overview about the aspects of creating management and administration performing work teams within Sport Organizations (federations, clubs etc), in order to produce a high level of services to all persons dealing with sport, especially to elite athletes. Another interesting moment was the overview of Croatian sport systems and similarities and comparisons with the Albanian Sport system, being both Eastern and post-communist countries.

The participants to the seminar were Secretary Generals of sports organizations, sports clubs, and professors at AEFS. Also in the frame of cooperation with neighboring countries, there were participants from the Commune of Tuz, Montenegro.

